



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr. 44/2026

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Ramush Bardiqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në vendvotimin nr.3501/01 në Ranillug, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 07.06.2026, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 12.06.2026, merr këtë:

V E N D I M

PRANOHET E BAZUAR ankesa ZP.Anr. 44/2026, e datës 09.06.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Ranillug, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 07.06.2026, ashtu që urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), respektivisht Qendra Komunale e Numërimit në Ranillug, që 4 fletëvotime në vendvotimin-kutia e votimit Nr. 3501/01, të vlerësohen si të vlefshme, të njëjtat të rinumërohen dhe të përfshihen në rezultatin zgjedhor.

A r s y e t i m

Me datë 09.06.2026, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik, Lista Serbe, me seli në Mitrovicë të Veriut, në të cilën pretendon se me datën 08.06.2026 në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), gjatë numërimit të votave nga vendvotimi 3501/01, në mes orës 12:00 dhe 13:00, kanë vërejtur se votat e Listës Serbe u shpallën të pavlefshme me arsyetimin se subjekti politik ishte shënuar me këto simbole: W, =, %, @.

Në ankesë theksojnë se subjekti i tyre politik është dëmtuar, sepse në fletëvotime shihet qartë qëllimi i votuesit dhe se në këtë mënyrë po shtrembërohet vullneti i votuesve. Në bashkëngjitje të ankesës kane dorëzuar fotografitë si provë, dhe si dëshmitarë të mundshëm kane paraqitur Milosh Krstiq, Nenad Stoilkoviq, Aleksandra Petroviq

KQZ, në përgjigje në ankesë ka thekuar se, bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike. Në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit, në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: Janë shënuar më shumë se një subjekt politik; Nuk është shënuar asnjë subjekt politik; Janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik; Qëllimi i votuesit nuk është i qartë. Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkitazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit. Në Procedurën e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me dt. 23.05.2026, nr., 01/955-2026, parashihen shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026 (Shih procedurat e votimit dhe numërimit në vendvotim Për zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 07.06.2026). KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Ranillugut, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve - QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjet në ankesë ka gjetur se:

Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerësoi se pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik Lista Serbe me të cilën pretendon se gjatë numërimit të fletëvotimeve në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), në Ranillug gjatë numërimit të votave nga vendvotimi 3501/01, votat e subjektit politik Lista Serbe janë shpallur të pavlefshme me arsyetimin se subjekti politik ishte shënuar me këto simbole: W, =, %, @, Paneli i vlerësoi se janë të qëndrueshme, pasi që nga hetimi i kryer nga ana e Panelit janë vërtetuar të gjitha këto pretendime.

Me dispozitën e nenit 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024 2024 Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, parashihet që: “Vota është e vlefshme, kur votohet vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë qëllimi i votuesit: 2.1. në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e vlefshme nëse votuesi ka votuar për një (1) subjekt politik”. Ndërsa paragrafi 2.2 i po të njëjtit nen parasheh që: “në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, vota konsiderohet e pavlefshme, në rastet kur: 2.2.1. Kur votohet më shumë se një subjekt politik; 2.2.2. kur nuk votohet asnjë subjekt politik; 2.2.3. kur votohen vetëm kandidatët dhe jo subjekti politik; 2.2.4. kur qëllimi i votuesit nuk është i qartë, sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim.”

Paneli ka vlerësuar se nga ana e Qendrës Komunale të Numërimit (QKN) në Ranillug, nga vendvotimi 3501/01, 4 (katër) fletëvotime janë shpallur të pavlefshme në kundërshtim me dispozitën ligjore nga neni 16 par.2 paragrafi 2.1 i Rregullores Zgjedhore Nr.12.2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit dhe me këtë rast e urdhëroi KQZ-në, përkatësisht QKN në Ranillug që të njëjtat fletvotime ti konsideroi si të vlefshme, ti rinumëroi dhe ti përfshijë në rezultat.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli duke u mbështetur në nenin 16 par.2 nën paragrafi 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024, vlerëson se, votat konsiderohen të pavlefshme vetëm në rastet si në vijim: Votohet më shumë se një subjekt politik, nuk votohet asnjë subjekt politik, votohet vetëm kandidati e jo subjekti politik, dhe qëllimi i votuesit nuk është i qartë sipas procedurave të votimit dhe numërimit në vendvotim. Prandaj në rastin konkret 4 fletëvotimet të cilat janë shpallur të pavlefshme nuk hyjnë në kategorinë e fletëvotimeve të pavlefshme siç e parasheh dispozita ligjore e lartcekur, në rastin e pavlefshmërisë së votës, kjo pasi që vota është e vlefshme kur dihet qartë qëllimi i votuesit, e që në rastin konkret nga provat e dorëzuara nga ana e ankuesit shihet qartë qëllimi i votuesit, për këtë arsye Paneli ka vendosur që të pranoj si të bazuar ankesën e ankuesit duke e detyruar KQZ-në që t'i vlerësoj si të vlefshme, të njëjtat të rinumërohen dhe të përfshihen në rezultatin zgjedhor.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par. 1 dhe 5 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZP Anr.44/2026, datë 12.06.2026

Kryesuese e Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.